

**ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË SË
GJYQTARËVE TË GJYKATËS
KUSHTETUESE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

**ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURISË SË GJYQTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Maj 2017

Publikuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Blv. Gjergj Fishta, Nr. 5/22, Tiranë, Shqipëri
<http://birn.eu.com/>

Përgjegjës: Kristina Voko
Besar Likmeta

Grafika: Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2017

Përmbajtja:

I.	Hyrje	6
	Qëllimi i këtij studimi	7
II.	Metodologjia e studimit	10
	Kampionimi	10
	Hedhja e të dhënave në bazën e të dhënave	11
	Analizimi i të dhënave	14
	Kufizime të metodologjisë	14
III.	Gjetjet e studimit	16
	Asetet – pasuria bruto	17
	Ndryshimet në pasurinë bruto	18
	Nënkategoritë e aseteve	20
	Detyrimet	23
	Totali i Detyrimeve	23
	Raporti Asete-Detyrime	24
	Detyrimet e pashlyera	26
	Pasuria neto	27
	Të ardhurat	28
	Totali i të ardhurave	29
	Burimi i të ardhurave	30
	Shpenzimet	32
	Të ardhurat neto	33
	Kontrolli aritmetik dhe logjik	34
IV.	Diskutime dhe rekomandime	39
	Aneksi I: Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive	41
	Aneksi II: Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë	42

I. Hyrje

Ashtu si shumë vende anembanë botës, Shqipëria ka prezantuar në vitin 2003 një sistem për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë, ku përfshihen dhe gjyqtarët dhe prokurorët. Sipas Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, prokurorët dhe gjyqtarët në Shqipëri e deklarojnë periodikisht pasurinë dhe burimet e krijimit si dhe detyrimet e tyre financiare. Edhe pse ky sistem kontrolli njihet si një mjet i fuqishëm në luftën kundër korrupsionit, impakti i tij në uljen e nivelit të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Shqipëri është i paqartë.

Vende të ndryshme, apo institucione dhe grupe interesi si qeveria, shoqëria civile dhe komuniteti ndërkombëtar, jo gjithmonë janë dakord mbi rolin e sistemit të deklarimit të pasurisë; megjithatë, të gjithë këta aktorë përgjithësisht bien dakord mbi disa qëllime bazë mbi funksionin e tij:

- Të rrisë transparencën dhe besimin e qytetarëve në administratën publike dhe gjyqësorin, duke zbardhur informacione mbi asetet e politikanëve, prokurorëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë.
- Të ndihmojë krerët e institucioneve që të parandalojnë konfliktin e interesit, në mënyrë që të promovojnë integritetin brenda institucioneve.
- Të monitorojë pasurinë e politikanëve, gjyqtarëve ose zyrtarëve individualë, në mënyrë që të parandalojë sjellje korruptive, duke hedhur dritë mbi pasuritë e paligjshme, si dhe njëkohësisht t'i mbrojë ata nga akuzat false.

Gjatë dy viteve të fundit, Shqipëria është përfshirë në një reformë të thellë strukturore të sistemit të drejtësisë, e cila shihet si një hap kyç në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara si pjesë e reformës në drejtësi, parlamenti votoi me 30 gusht 2016 ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ashtuquajtur i vetingut. Ky ligj është i pari i një pakete prej 48 ligjesh që do të përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të reja që do të dalin nga reforma kushtetuese. Ligji i vetingut imponon kontrollin e integritet të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga një komision i pavarur, lidhur me komponentët e pasurisë, pastërtisë së figurës dhe vlerësimit profesional. Në vlerësimin e tij të pasurisë të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit do të mbështetet në të dhënat e pasqyruara në deklaratat e pasurisë të administruara nga ILDKPKI si dhe hetimet administrative të ndërmarra nga ky institucion.

Në prag të një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, që ka nisur dhe është në fazën e parë të miratimit të paketës ligjore, vlerësimit të pasurisë dhe ligjshmërisë së saj po i jepet një rëndësi e veçantë. Duke pasur parasysh rolin që hetimi pasuror do të ketë në procesin e vetingut, gjatë vitit 2016, BIRN Albania mori në studim pasuritë e gjyqtarëve të Apelit në Republikën e Shqipërisë, me

qëllim që të identifikonte trendet kryesore të të ardhurave dhe vënies së pasurisë nga këto gjyqtarë, të cilët kanë një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe përbëjnë një të katërtën e të gjithë trupës gjyqësore në vend.

Të dhënat e dala nga ky studim ndihmuan jo vetëm në rritjen e transparencës lidhur me pasurinë e gjyqtarëve të apelit, por mundësuan gazetarët dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile që të hulumtonin më shumë në këtë fushë.

Qëllimi i këtij studimi

Duke pasur parasysh rolin që hetimi pasuror do të ketë në procesin e vetingut, por dhe metodologjinë e zhvilluar gjatë raportit të mësipërm, BIRN Albania mori në studim pasuritë e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të identifikonte tendencat kryesore të të ardhurave dhe vënies së pasurisë nga këto gjyqtarë, të cilët bëjnë pjesë në instancën më të lartë gjyqësore në vend.

Të dhënat primare të këtij studimi bazohen në analizimin sasior dhe cilësor të vetëdeklarimeve të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të marra nga ILDKPKI nëpërmjet kërkesave për kopje të dokumenteve publike bazuar në Ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Të dhënat dytësore për këtë studim bazohen në raportet e botuara më parë mbi këtë fushë nga BIRN Albania dhe organizata të tjera, si dhe praktikat më të mira ndërkombëtare për vlerësimin dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar.

Objekt i këtij studimi janë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese që kanë qenë në funksion deri në dorëzimin e deklarimit periodik vjetor 2015 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Pra, pasuria e tyre dhe burimi financiar i deklaruar, për shkak të kohëzgjatjes së detyrimit ligjor për deklarim pasurie, mund të jetë objekt studimi dhe të sjellë rezultate krahasuese.

Studimi hedh dritë jo vetëm mbi mënyrën e akumulimit të pasurisë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, por edhe mbi teknikat e identifikuar si ‘flamuj të kuq’ të fshehjes së prejardhjes së kësaj pasurie; ku përfshihen dhurata apo huamarrje nga familjarë dhe persona të lidhur, transaksione të shumta imobiliare dhe qiradhënie, si dhe mbajtja e likujditeve në Cash jashtë sistemit bankar.

Ky raport ka për qëllim të ofrojë një panoramë të qartë mbi strukturën dhe origjinën e pasurisë të deklaruar të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke identifikuar ‘flamujt e kuq’ që mundësojnë analizimin e problematikave dhe sfidave të sistemit të kontrollit të pasurisë, si dhe duke analizuar problematikën dhe sfidat e sistemit ekzistues në përmbushje të funksionit të tij.

Gjykata Kushtetuese¹

Institucioni

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton në nenin 7 të saj ndarjen e pushteteve duke e vënë atë në themel të funksionimit të demokracisë. Në një republikë demokratike pushteti ekzekutiv dhe parlamentar bashkëpunojnë ngushtë në mënyrë që të nxjerrin dhe zbatojnë aktet ligjore të duhura për ecurinë e shoqërisë. Ndërsa pushteti i tretë, ai gjyqësor, është i ngarkuar me detyrën për të mbrojtur qytetarët nga cënimet e paligjshme të të drejtave të tyre qoftë edhe nga organet e pushtetit publik. Detyra për garantimin dhe respektimin e Kushtetutës nga veprimtaria e pushtetit publik i është ngarkuar Gjykatës Kushtetuese. Ajo është instanca e fundit e ngarkuar me kontrollin ndaj akteve të nxjerra nga organet e pushtetit shtetëror duke u përqendruar në aspektin e pajtueshmërisë së tyre me dispozitat kushtetuese.

Gjatë veprimtarisë së saj që nga krijimi në vitin 1992 e gjer më sot Gjykata Kushtetuese ka pasur rastin të shqyrtojë çështje të natyrave dhe përmasave të ndryshme duke krijuar hap pas hapi një praktikë të pasur, ku të bie në sy përpjekja e vazhdueshme për t'i dhënë mbrojtjen e duhur parimeve kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese luan një rol ekujlibruës për mbrojtjen e sistemit të ndarjes dhe kontrollit të ndërsjellët të pushteteve, si një parim themelor të shtetit të së drejtës.


Përbërja

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të

¹http://www.gjkr.gov.al/web/Gjykata_Kushtetuese_L1.php

njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj (neni 125 i Kushtetutës). Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve kur ai ka vepruar për një interes vetjak ose me keqbesim (neni 126 i Kushtetutës).



II. Metodologjia e studimit

Kampionimi

Ky studim është bazuar në përpunimin dhe analizimin e të dhënave të deklaratave të pasurisë së 9 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Deklaratat e pasurisë janë marrë në mënyrë elektronike nga Inspektorati i Lartë, pas kërkesës me shkrim drejtuar këtij institucioni, bazuar në ligjin nr.119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit". Secili formular deklarimi përmban të gjitha të dhënat e deklaruara nga subjekti deklarues, përveç të dhënave konfidenciale (siç janë: faqja e të shpenzimeve të deklarueshme, të dhëna si p.sh. adresat e shtëpive, numrat e llogarive bankare, emrat e personave të tretë etj).

Për qëllim të këtij studimi janë marrë në analizë të gjithë formularët e deklarimit të gjyqtarëve, nga deklarimi i parë (Deklarata Para Fillimit të Detyrës), si dhe çdo deklarim periodik/vjetor i interesave private deri në vitin 2015. Në çdo rast, kur në këtë studim është cituar pasuria/detyrimet/të ardhurat apo shpenzimet e gjyqtarit, duhet të nënkuptojmë gjyqtarin dhe familjarët e tij, përveç rasteve kur do të shprehet në mënyrë specifike pronësia e familjarëve si e ndarë më vete nga ajo e gjyqtarit (si subjekt deklarues).

Bazuar në sa më lart, objekti i analizës së këtij studimi janë 106 deklaratat të interesave private të 9 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Siç vihet re dhe nga Tabela nr.1, këta 9 gjyqtarë kanë periudha të ndryshme të deklarimit të pasurive dhe periudha të ndryshme të emërimit në Gjykatën Kushtetuese.

Tabela nr.1: Vitet e deklarimit pranë ILDKPKI dhe vitet në funksionin aktual të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti	Vitet si subjekt deklarimi në ILDKPKI	Vitet në funksion në Gjykatën Kushtetuese
Altina Xhoxhaj	12	6
Bashkim Dedja	12	6
Besnik Imeraj	12	3
Fatmir Hoxha	12	5
Fatos Lulo	11	3
Gani Dizdari	9	3
Sokol Berberi	9	9
Vitore Tusha	8	8
Vladimir Kristo	10	9

Nga një lexim formal i formularëve të deklarimit të interesave private të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, konstatohet se:

- Altina Xhoxhaj është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2003, dhe është emëruar Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese me datë 25.05.2010;
- Bashkim Dedja është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2003, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 25.05.2010;
- Besnik Imeraj është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2003, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 08.04.2013;
- Fatmir Hoxha është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2003, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 04.07.2011;
- Fatos Lulo është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2004, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 02.05.2013;
- Gani Dizdari është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2006, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 02.03.2013;
- Sokol Berberi është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2007, me emërimin Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 25.04.2007;
- Vitore Tusha është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2008, me emërimin Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese me datë 10.03.2008;
- Vladimir Kristo është subjekt i deklarimit të interesave private pranë ILDKPKI-së nga viti 2005, dhe është emëruar Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me datë 01.06.2007.

Hedhja e të dhënave në Database (bazën e të dhënave)

Të dhënat e deklaratave të interesave private janë regjistruar në bazën e të dhënave sipas një standardi unifikues, i ndjekur me përpikëri nga ekspertët e angazhuar me procesin e hedhjes së të dhënave. Për të kryer një kategorizim të saktë të të dhënave të deklaratave të pasurisë i jemi referuar: dy ligjeve bazë të ILDKPKI-së si dhe Udhëzimeve për plotësimin e formularëve të deklarimit të interesave private të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

Baza e të dhënave (database) është ndërtuar në formatin Excel, një tabelë e organizuar në kolona dhe rreshta, duke bërë të mundur që çdo e dhënë e deklaratës që hidhet në këtë tabelë të jetë e qartë, e plotë dhe lehtësisht e identifikueshme se cilit subjekt i përket, cilës deklaratë, cilit vit etj. Çdo e dhënë e pasqyruar në deklaratat e interesave private është “zbërthyer” dhe hedhur në qelizat përkatëse.

Përveç gjeneraliteteve dhe të dhënave mbi funksionin e gjyqtarit, datës së emërimit në detyrë, institucionit ku ka ushtruar profesionin përgjatë të gjithë viteve, etj., pjesa më e rëndësishme është informacioni i deklaruar lidhur me pasurinë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet. Këto të dhëna janë grupuar në katër kategori të mëdha: (1) asete; (2) detyrime; (3) të ardhura dhe (4) shpenzime.

Secila nga këto kategori është detajuar në nënkategori duke iu referuar përkufizimeve të nenit 4 të ligjit Nr.9049, datë 10.04.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, për objektin e deklarimit si dhe rasteve më tipike të ndeshura në formularët e deklarimit, siç është për shembull: detyrimi i mbetur pa shlyer ndaj shoqërive sipërmarrëse, të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme (e shprehur si formë fitimi për shkak të transaksionit të blerjes dhe shitjes me diferencë çmimi), etj. Të gjitha nënkategoritë e përdorura në kodifikimin e të dhënave të deklaruara nga gjyqtarët dhe familjarët e tyre, janë të pasqyruara në Aneksin I të këtij raporti ‘Kodifikimi i Kategorive dhe Nënkatëgorive’.

Disa nga elementët e marrë parasysh gjatë hedhjes së të dhënave të deklaratave dhe kontrollit të tyre, janë:

- Kolona e kategorive dhe nënkategorive është e plotësuar me kodet dhe nënkodet sipas tabelës së paraqitur në Aneksin I, me qëllim unifikimin e të dhënave dhe mundësimin e përpunimit të gjithë informacionit të disponueshëm.
- Kur deklarimi është bërë nga personat e lidhur, ky fakt evidentohet në kolonën “person i lidhur” duke plotësuar një nga opsionet, nëse bëhet fjalë për bashkëshort/e; fëmijë; apo të tjerë (si prindër, motra, vëllezër etj) që pavarësisht se nuk kanë detyrim ligjor për të deklaruar, shpesh herë janë përfshirë në vetëdeklarim.
- Të dhënat e tjera që i përkasin kategorive: (1) asete; (2) detyrime; (3) të ardhura dhe (4) shpenzime, janë regjistruar fillimisht në versionin narrativ, duke pasqyruar saktësisht çfarë ka deklaruar subjekti, dhe më pas në kolonën “shuma në Lekë” është përlllogaritur vlera në Lekë sipas deklarimit.
- Në rastet kur është deklaruar vlera në monedhë të huaj, në kolonën “shuma në Lekë” është bërë konvertimi në Lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 31 Dhjetor të vitit të cilit i përket deklarimi. Në Aneksin II të këtij raporti janë pasqyruar në mënyrë të detajuar të gjitha kurset e këmbimit të përdorura sipas viteve përkatëse, për monedhat EURO, USD, GBP, CHF, CAD.

- Kur në deklaratat Periodike/Vjetore, gjyqtarët dhe familjarët e tyre kanë deklaruar pakësim të aseteve apo shitje të aseteve në pronësi (të deklaruara në deklaratimet e mëparshme), regjistrimi i vlerës së këtij asetit të shitur ose pakësuar, është shënuar me minus (-). Këtu dallojmë dy raste:
 1. Në rastet e shitjes së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, vlera që pakësohet është çmimi i asetit siç është deklaruar në periudhën e krijimit. Pra pasqyrohet pakësimi i asetit në kategorinë e aseteve. Në rastet kur ka pasur diferencë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes, atëherë kjo diferencë është pasqyruar në kategorinë e të ardhurave si burim të ardhurash për periudhën e deklaratimit;
 2. Në rastin e pakësimit të likuiditeteve (Cash, bankë), pra kur deklarohet pakësim apo tërheqje depozite apo gjendje Cash, ky veprim është regjistruar në kategorinë e aseteve duke vendosur në kolonën "shuma në Lekë" shumën që është pakësuar me shenjën minus (-).
- Për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë deklaruar si dhurata, regjistrimi i vlerës së tyre është shënuar zero lekë (0) në rastet kur nuk është shënuar vlerë.
- Për çdo dhuratë e cila është deklaruar në formë asetit apo është shpenzuar, në bazën e të dhënave është bërë regjistrim i dyfishtë, duke pasqyruar vlerën e dhuruar si aset apo shpenzim, si dhe burimin si të ardhur nga dhurata (kjo e fundit është regjistruar si një nënkategori e veçantë tek të ardhurat).
- Në rastin kur janë deklaruar pasuri të paluajtshme të përfituara nga Ligji nr.7501, është shënuar vlera zero lekë (0) për ato raste kur vetë subjekti nuk ka shënuar vlerë.
- Për sa i përket shlyerjes së kësteve të kredisë apo detyrimeve të tjera, të cilat janë deklaruar në rubrikën e detyrimeve në formularin e deklaratimit, ka qenë e pamundur të ndahet pjesa e principalit nga interesi i paguar, pasi në çdo rast është deklaruar në total kësti i paguar. Meqenëse interesi duhet të ishte trajtuar si shpenzim ndërsa principalin si pakësim i detyrimeve, në këto kushte kur informacioni për pagesën e interesave mungon, kësti i paguar në total është trajtuar si pakësim detyrimesh
- Në rastet kur një detyrim i lindur brenda periudhës deklaruese (qoftë kjo kredi, huamarrje, etj.) është kthyer po brenda vitit apo periudhës deklaruese, atëherë ky veprim regjistrohet dy herë në kategorinë e detyrimeve: një herë vlerë pozitive dhe një herë si pakësim detyrimi, pra me minus (-).
- Në shumë raste ka pasur përsëritje të aseteve dhe detyrimeve, duke shënuar në dy ose më shumë vite rresht të njëjtat të dhëna. Ky informacion është pasqyruar në kolonën "Përshkrimi" në bazën e të dhënave, ndërsa në kolonën "shuma në Lekë" është shënuar vlera zero lekë (0),

me qëllim shmangien e shtesës artificiale të pasurisë apo detyrimeve.

- Në rastin e likuiditeteve (Cash apo në bankë), subjektet deklarues nuk kanë respektuar në çdo rast detyrimin ligjor për të deklaruar ndryshimet në krahasim me vitin paraardhës, pra shtesa apo pakësime, por kanë deklaruar gjendjen në fund të periudhës deklaruese. Kur ka qenë e mundur identifikimi dhe lidhja logjike e gjendjes aktuale me të dhënat e deklaruara në vitin paraardhës, ekspertët kanë përlogaritur sa ka qenë ky ndryshim në vlerë monetare. Në rastet kur ka qenë e pamundur identifikimi se cila llogari bankare ka ndryshuar, atëherë është marrë si e mirëqenë që shuma e deklaruar është shtesë për periudhën.
- Në rastet kur subjekti ka deklaruar se pasuria e paluajtshme është rivlerësuar, sipas ligjeve në fuqi, është shënuar vlera e rivlerësuar e objektit, me qëllim që të kemi një vlerë reale të pasurive aktuale në pronësi të subjektit, dhe njëkohësisht me qëllim justifikimin e shtimit të vlerës, kemi shtuar një nënkategori të re tek Të Ardhurat, 'Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme'.

Analizimi i të dhënave

Pas hedhjes në Database (formati excel) të të dhënave të deklaratave të interesave private nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2015 për 9 gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, filloi faza e analizimit dhe përpunimit të të dhënave. Mënyra e përpunimit të të dhënave dhe paraqitjes grafike është bërë me metodën Pivot Table dhe programin Power BI Desktop. Përpunimi i të dhënave me Pivot Table, ofron fleksibilitet në manipulimin e informacionit, në gjenerimin e tabelave specifike dhe raporteve, me saktësi të lartë dhe në mënyrë eficiente; ndërsa programi Power BI Desktop, ofron paraqitje grafike me ilustrime të qarta dhe lehtësisht të interpretueshme.

Kufizime të metodologjisë

Në disa nga rubrikat e formularit të deklarimit janë konstatuar parregullsi në mënyrën e plotësimit të formularit. Disa nga elementët e marrë parasysh gjatë hedhjes së të dhënave të deklaratave dhe kontrollit të tyre, të cilat njëkohësisht janë dhe sinjalizues të pakujdesive ose gabimeve në plotësimin e deklaratave dhe analizimin e tyre, janë:

1. Në deklaratat Periodike/Vjetore është deklaruar gjendja e likuiditeteve në vend që të deklarohet ndryshimi i gjendjes (shtesë apo pakësim) krahasuar me vitin paraardhës;

1. Rideklaruar i njëjti aset dhe/apo detyrim, në dy ose më shumë periudha deklaruese;
2. Deklaruar nga vetë subjekti deklarues, pasuria dhe detyrimet në emër të personave të lidhur (bashkëshort/e, fëmijë madhorë), të cilët duhet të ishin plotësuar nga vetë personat e lidhur në formularin përkatës në faqen nr.7-12;
3. Është deklaruar shitje e një prone, të padeklaruar më parë, në deklaratat paraardhëse;
4. Deklarimi jo i plotë i të dhënave lidhur me kontratat e sipërmarrjes, për rastin kur jepet trualli për ndërtim, dhe nuk është e qartë pjesa takuese që përfton subjekti;
5. Mungesë informacioni nga ana e subjektit deklarues lidhur me destinacionin e të ardhurave nga shitja e pasurive të paluajtshme (nëse janë riinvestuar, mbahen cash apo janë shpenzuar);
6. Në rubrikën e të ardhurave dhe detyrimeve, është deklaruar shënimi “nuk ka ndryshim”, por subjekti deklarues ka pasur detyrimin ligjor të deklarojë saktësisht të ardhurat neto për atë periudhë dhe shlyerjen e pagesës vjetore (pasi ka deklaruar detyrimeve në periudhën paraardhëse);
7. Ka mungesë firmash në faqet e plotësuara nga gjyqtarët, pra në faqet ku ka të dhëna dhe nënshkrimi është i detyrueshëm;
8. Nuk janë shënuar me fjalë vlerat dhe çmimet, por vetëm me shifra; ose ka raste kur vlera me shifra është e ndryshme nga vlera në lekë; subjektet kanë deklaruar vlera me lekë të vjetër dhe jo me lekë të rinj;
9. Një kufizim i rëndësishëm, është dhe trajtimi si informacion konfidencial nga ana e ILDKPKI-së i shpenzimeve të deklarueshme.

Nga sa u përmendën në pikat e mësipërme nënkuptohet se edhe analiza statistikore ka një marzh gabimi, në raport të drejtë me gabimet materiale që janë gjendur në formularët e deklaramit.

III. Gjetjet e studimit

Gjatë dy dekadave të fundit, shumë vende kanë ngritur sisteme për kontrollin dhe vlerësimin e pasurive të zyrtarëve publik, çfarë ka sjellë edhe një eksperiencë të akumuluar ndërkombëtare mbi praktikën më të mira dhe metodologjitë për të verifikuar të dhënat financiare që këta zyrtarë deklarojnë. Ashtu si edhe në vende të tjera, procedura e deklarimit dhe e kontrollit të pasurisë në Shqipëri, ndahet nga ILDKPKI në regjistrimin e formularëve të deklarimit të pasurisë, përpunimi paraprak i tyre, kontrolli aritmetik dhe logjik, si dhe në raste të caktuara, verifikimi ose hetimi administrativ.

Në mënyrë që të identifikonte trende transaksionesh, të cilat përdoren nga këto subjekte për të legalizuar pjesë të paligjshme të pasurisë së tyre, të cilat në praktikën më të mira ndërkombëtare identifikohen si 'flamuj të kuq', BIRN ndërmori një analizë të detajuar të strukturës së asetëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës 2003-2015.

Sipas praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, të gjithë 'flamujt e kuq' duhet të ishin shtysë për organe si ILDKPKI për të filluar një audit të plotë për subjektin për të cilin ato konstatohen. Audit i plotë ka për qëllim përdorimin e të gjitha mundësive përtej deklaratës, për të identifikuar parregullsi financiare nga subjekti. Objekti i një audit të plotë ose kontrolli të plotë administrativ nuk është deklarata në vetvete, por subjekti deklarues dhe personat e lidhur, me të cilët ai ka kryer transaksione financiare. Qëllimi i kontrollit të plotë administrativ është që institucioni/inspektoriat të sigurohet që të ardhurat e zyrtarit që është objekt i kontrollit dhe të familjarëve të tij, kanë një burim të ligjshëm, të hetojë nëse ka pasuri të fshehura, si dhe të identifikojë çdo lloj shpenzimi të kryer që mund të jenë krijuar me burime të ardhurash të paligjshme.

Në mungesë të të dhënave mbi hetimet administrative të ndërmarra nga ILDKPKI, për të vlerësuar punën e këtij institucioni, BIRN analizoi të dhënat e mbledhura nga 106 deklaratat e pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Qëllimet kryesore të kësaj analize janë:

- Identifikimi i "flamujve të kuq", rasteve kur deklaratat përmbajnë të dhëna që krijojnë dyshime për burime të paligjshme të pasurisë bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare, të cilat duhet të shërbejnë si indicie për hetime më të thelluara të deklaratave;
- Kryerja e kontrollit aritmetik-logjik të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Kontrolli aritmetik dhe logjik, kryhet çdo vit kalendarik nga Inspektoriati, për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruara. Duke qenë se ky kontroll mbështet vetëm tek të dhënat e deklaramëve të subjekteve dhe të familjarëve të tyre, BIRN përzgjedhi këtë metodë kontrolli për të analizuar në mënyrë të pavarur pasurinë e këtyre gjyqtarëve, si dhe punën e Inspektoriatit për të identifikuar të dhëna statistikore mbi pasuri dhe asete të ngritura me burime të paligjshme; dhe

- Përlllogaritja e shpenzimeve të deklarueshme dhe të shpenzimeve të konsumit, referuar të dhënave të deklaramëve, si diferencë mes të ardhurave neto dhe aseteve neto, për çdo deklaram periodik vjetor.

Bazuar në këto objektiva, seksionet e mëposhtme përmbledhin gjetjet mbi: *Asetet ose Pasurinë Bruto*; *Detyrimet* e deklaruara prej tyre; përlllogaritjen e *Pasurisë Neto* bazuar në të dhënat e kategorive Asete dhe Detyrime; *Të Ardhurat* dhe *Shpenzimet* e deklaruara; përlllogaritjen e të *Ardhurave Neto*; rezultatet e *Kontrollit aritmetik-logjik* të deklaramëve periodike/vjetore; përlllogaritjen mbi *Pasurinë e pajustificuar* të gjyqtarëve, si dhe përlllogaritja e *Shpenzimeve vjetore* për secilin nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Pra gjithsej, objekt i këtij studimi janë **106 deklaramta** të interesave private, të administruara nga Inspektoriati i Lartë i Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive.

1. ASETET – PASURIA BRUTO

Në konceptin e pasurisë bruto përfshihen zërat e aseteve të deklaruara nga zyrtarët dhe familjarët e tyre në formularin e deklaramit të pasurive, të cilat janë kategorizuar referuar nenit 4 të ligjit nr.9049 datë 10.4.2003, *“Për Deklaramin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nënpunësve Publikë”* të ndryshuar.

- Pasuri të paluajtshme;
- Pasuri të luajtshme;
- Likuiditete në Cash;
- Likuiditete në Bankë;
- Pjesë në kapital/Aksione;
- Person Fizik;

- Sende me vlerë të veçantë;
- Huadhënie;
- Asete të tjera (për ato asetë që nuk i përkasin kategorive të mësipërme).

Mënyra e deklarimit të interesave private nga subjekti deklarues, konsiston në deklarimin e gjendjes së asetëve që disponon, burimin e krijimit dhe detyrimeve financiare në momentin e marrjes së detyrës dhe ky deklarim quhet Deklarimi Para Fillimit të Detyrës; ndërsa në deklarimet në vijim, pra në deklaratat Periodike/Vjetore, zyrtari ka detyrimin ligjor të deklarojë ndryshimet në asetë dhe detyrime për periudhën deklaruese, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet e deklarueshme.

Për këtë arsye në përlogaritjen e vlerës së Asetëve dhe Detyrimeve në një moment të caktuar kohor, është e rëndësishme të përlogaritet vlera akumulative duke filluar nga deklarata fillestare.

Përkufizimet e mëposhtme ndihmojnë në kuptimin më të mirë të analizës së vlerës së asetëve:

- *Asete / Pasuria bruto fillestare* – Vlera totale e asetëve që subjekti deklarues dhe familjarët e tij zotërojnë në fillim të procesit të vetëdeklarimit;
- *Shtesat / Pakësimet vjetore* – Vlera e shtuar e asetëve për secilin vit deklarues; si dhe
- *Vlera akumulative e asetëve* – Ndryshimet në asetë / pasuri bruto ndër vite, në të cilën përfshihen vlera fillestare plus shtesat ose pakësimet vjetore të tyre.

1.a. Ndryshimet në pasurinë bruto

SI KA NDRYSHUAR PASURIA BRUTO, NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2015?

Bazuar në analizën e mundësuar nga baza e të dhënave e ngritur për qëllime të këtij studimi, gjendja fillestare e deklaruar e pasurisë (bazuar në deklaratat për vitin e parë të deklarimit), për gjyqtarët objekt i kësaj analize është në shumën 160.616.690 lekë.

Pas të gjitha ndryshimeve të deklaruara për gjendjen pasurore nga viti fillestar i deklarimit deri në fund të vitit 2015 (ku janë përlogaritur shtesa dhe pakësime sipas konceptit të plotësimit të formularit të deklarimit), rezulton se shuma totale e pasurisë bruto akumulative në fund të vitit 2015 është rreth 364.263.786 lekë, pra pasuria në total është rritur me 203.647.096 lekë.

Tabela nr. 2: Ndryshimi i pasurisë bruto gjatë periudhës së deklarimit.

Subjekti	Asetet Para Fillimit të Detyrës	Asetet me datë 31/12/2015	Ndryshimi i pasurisë (Lekë)
Altina Xhoxhaj	15.473.410	35.535.340	20.061.930
Bashkim Dedja	2.490.000	47.868.967	45.378.967
Besnik Imeraj	12.543.450	27.050.737	14.507.287
Fatmir Hoxha	1.700.000	23.383.913	21.683.913
Fatos Lulo	74.568.000	92.037.826	17.469.826
Gani Dizdari	7.897.216	37.153.671	29.256.455
Sokol Berberi	17.798.025	32.127.435	14.329.410
Vitore Tusha	4.310.114	13.428.520	9.118.406
Vladimir Kristo	23.836.475	55.677.377	31.840.903
Totali	160.616.690	364.263.786	203.647.096

Një faktor i rëndësishëm për t'u analizuar janë edhe vitet në funksion. Në tabelën nr. 3 më poshtë pasqyrohet rritja e pasurisë për periudhën nga fillimi i deklarimit e deri me datë 31.12.2015, vitet për të cilat janë subjekte të ligjit të deklarimit të pasurive si dhe në kolonën e fundit është Shtesa Mesatare Vjetore e Pasurisë.

Tabela nr. 3: Shtesa mesatare vjetore e pasurisë bruto.

Subjekti	Rritja e pasurisë (Lekë)	Vitet në Funksion	Shtesa mesatare vjetore e pasurisë
Bashkim Dedja	45.378.967	12	3.781.581
Gani Dizdari	29.256.455	9	3.250.717
Vladimir Kristo	31.840.903	10	3.184.090
Fatmir Hoxha	21.683.913	12	1.806.993
Altina Xhoxhaj	20.061.930	12	1.671.827
Sokol Berberi	14.329.410	9	1.592.157
Fatos Lulo	17.469.826	11	1.588.166
Besnik Imeraj	14.507.287	12	1.208.941
Vitore Tusha	9.118.406	8	1.139.801

Të renditur nga vlera më e lartë deri te vlera më e ulët, konstatohet se:

Rritjen me të madhe mesatare vjetore të pasurisë e kanë gjyqtarët Bashkim Dedja, Gani Dizdari dhe Vladimir Kristo. Ndërsa vlera më e ulët e shtesës mesatare vjetore të pasurisë shkon për gjyqtarin Besnik Imeraj.

1.b. Nënkatëgoritë e aseteve

CILAT JANË LLOJET E ASETEVE DHE RAPORTI NDËRMJET TYRE?

Duke qenë se në totalin e saj, rritja e pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk justifikohet nga të ardhurat e përftuara nga paga/shpërblimet, BIRN analizoi të dhënat e aseteve të deklaruara nga këta gjyqtarë, me qëllim identifikimin e qartë të burimit të shtimit të pasurisë.

Nënkatëgoritë që përbëjnë totalin e vlerës së aseteve të deklaruara nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, janë klasifikuar në: Pasuri të paluajtshme; Pasuri të luajtshme; Likuiditete në Cash; Likuiditete në Bankë dhe Sendë me vlerë të veçantë.

Raporti ndërmjet këtyre nënkategorive në vlerë në Lek dhe në përqindje, për të gjithë gjyqtarët deklarues objekt të këtij studimi, është prezantuar në Tabelën nr. 4 si më poshtë:

Tabela nr.4: Vlera progresive në lekë për secilën nënkategori asetesh dhe raporti mes tyre.

Asetet	Vlera në lekë me datë 31/12/2015	Raporti në %
Pasuri të Paluajtshme	199.917.217	55%
Likuiditete në Bankë	94.683.122	26%
Likuiditete në Cash	54.290.936	15%
Pasuri të Luajtshme	10.372.511	3%
Sendë me vlerë të veçantë	5.000.000	1%
Total	364.263.786	100%


Pra, pasuria e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, gjendje me datë 31.12.2015, përbëhet nga:

55% pasuri e paluajtshme; 26% likuiditete në bankë; 15% likuiditete Cash; 3% Pasuri e luajtshme (automjete) dhe 1% sende me vlerë të veçantë.

Vëmë re se në asnjë rast nuk ka pasur deklarim lidhur me huadhënie apo zotërim të pjesëve në akcione/apo kapital nga ana e subjekteve deklarues apo familjarëve të tyre.

Për të parë se cila nga këto kategori ka pasur ndryshimin neto² më të madh, na ndihmon vizualisht grafiku i mëposhtëm (Grafiku nr. 1), ku vihet re se pasuritë e paluajtshme kanë rritjen më të madhe në vlerë, që do të thotë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë investuar më së shumti në sektorin imobilar.

Grafiku nr.1: Ndryshime në vlerën e nënkategorive të aseteve gjatë periudhës së raportimit



Pasuri të Paluajtshme: 9 gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në vend, në fund të vitit 2015, zotërojnë pasuri të paluajtshme në vlerë të përafërt 200 milion lekë, pasuri të cilat përbëjnë dhe 55% të aseteve të tyre të deklaruara.

Janë rreth 1.6 milion USD (199.917.217 lekë) të investuara në pasuri të paluajtshme nga 9 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

² I referohemi me termin ndryshim neto, pasi përlogariten të gjitha shtesat apo pakësimet që ka pësuar kategoria e aseteve nga deklarimi për herë të parë deri në datë 31.12.2015

Në këtë vlerë nuk janë të përfshira pasuritë e paluajtshme të përfituara nga privatizimi (ligji nr.7501) dhe/apo nga kontratat e sipërmarrjes për dhënie për ndërtim të truallit, pasi në secilin nga këto raste vlera është shënuar 0 nga subjekti deklarues.

Likuiditete në Bankë dhe në Cash: Duke marrë parasysh vlerat fillestare të deklaruara nga 9 gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në formularët para fillimit të detyrës (viti 0), si dhe duke ndjekur të gjitha deklaratimet e viteve pasardhëse lidhur me shtesat ose pakësimet e likuiditeteve, në fund të vitit 2015 rezulton se vlera akumulative e likuiditeteve në bankë është 94.683.122 lekë, ndërsa ajo e likuiditeteve në cash 54.290.936 lekë, duke përfaqësuar respektivisht 26% dhe 15% të vlerës së të gjithë asetëve të deklaruara.

Gjendja e likuiditeteve Cash, vazhdon të mbetet në nivele të larta, edhe pse në amendimet e fundit ligjore të ligjit nr.9049 datë 10.4.2003, i ndryshuar, në nenin 4/1 përcaktohet që limiti i lejuar për gjendje Cash në shtëpi është në shumën 1.5 milionë lekë dhe mbi këtë limit subjekti është i detyruar me ligj të bëjë depozitim në bankë.

Ky limit është i diskutueshëm në zbatim, pasi mbetet i paqartë nëse kufizimi vlen vetëm për deklaratuesit për herë të parë të interesave private apo për të gjithë subjektet që deklarojnë në mënyrë periodike.

Gjendja e likuiditeteve Cash me datë 31.12.2015, për secilin nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese sipas vetëdeklarimit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.5: Vlera akumulative e likuiditeteve në cash

Subjekti	Likuiditete ne Cash
Altina Xhoxhaj	14.560.240
Bashkim Dedja	4.654.295
Besnik Imeraj	3.501.580
Fatmir Hoxha	1.597.804
Fatos Lulo	18.080.000
Gani Dizdari	9.487.617
Vitore Tusha	1.308.800
Vladimir Kristo	1.100.600
Total	54.290.936



Rreth 15% e vlerës totale të asetëve mbahet në formën e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar

2. DETYRIMET

Përveç asetëve të krijuara gjatë periudhës së deklarimit të pasurisë, gjyqtarët kanë krijuar dhe detyrime financiare ndaj institucioneve financiare, personave të lidhur, si dhe ndaj kompanive të ndryshme, kryesisht atyre të ndërtimit.

Kategoria e detyrimeve përfshin këto nënkategori:

- Kredi bankare;
- Huamarrje ndaj personave të tretë;
- Detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit;
- Detyrime të tjera.

Nga analizimi i deklaratave vihet re se detyrimet janë një nga mënyrat e përdorura gjerësisht për financimin dhe investimin në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme nga ana e subjekteve deklarues dhe familjarëve të tyre. Në më pak raste evidentohet se këto detyrime janë përdorur për të mbuluar shpenzime shkollimi, apo shpenzime të llojit konsumator.

2.a. Totali i Detyrimeve

SA ËSHTË TOTALI I DETYRIMEVE NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2015?

Tabela 6 pasqyron gjendjen totale të detyrimeve të deklaruara nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese deri me datë 31.12.2015 dhe vlerën në lekë dhe në përqindje të nënkategorive që përbëjnë Detyrimet.

Tabela nr.6: Raporti në vlerë dhe përqindje mes nënkategorive të ndryshme të detyrimeve

Detyrimet	Shuma në lekë deri me 31.12.2015	Raporti në %
Kredi Bankare	47.412.096	53%
Detyrime shoq. ndertimit	32.885.937	37%
Huamarrje	8.444.905	10%
Total	88.742.938	100%

Nga vlera totale e detyrimeve, rezulton se:

53% e zënë detyrimet nga bankat, kryesisht të llojit kredi hipotekore, overdraft, kredi konsumatore; 37% e zënë detyrimet ndaj shoqërive të ndërtimit, (për rastet kur nuk likuidohet e plotë vlera e kontratave); dhe 10% janë huamarrje ndaj të tretëve, kryesisht janë hua pa afat dhe pa interes dhënë nga miq apo të afërm të subjekteve deklarues.

Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, detyrimet e larta jashtë sistemit bankar, si huamarrja ndaj personave të tretë dhe detyrimet e pashlyera ndaj kompanive të ndërtimit, konsiderohen gjerësisht si indikatorë transaksionesh të dyshimta të rrjedhjes së parasë në hyrje dhe identifikohen në manulet për procedimin dhe analizimin e deklaratave të pasurisë si 'flamuj të kuq'. Shumat e larta të detyrimet ndaj kompanive të ndërtimit (37%) dhe huamarrjes jashtë sistemit bankar (10%) dhe janë një tregues i nevojës për një hetim më të detajuar të deklaratave nga ana e institucioneve monitoruese të sistemit.



Rreth 47% e vlerës së detyrimeve të gjykatësve lidhet me detyrime ndaj kompanive të ndërtimit dhe huamarrje ndaj personave të tretë.

2.b. Raporti Asete-Detyrime

CILI ËSHTË RAPORTI MES VLERËS SË DETYRIMEVE DHE ASETEVE DERI NË FUND TË VITIT 2015?

Një analizë krahasuese mes totalit të aseteve dhe totalit të detyrimeve të deklaruar ndë vite për secilin nga subjektet objekt studimi paraqitet në mënyrë tabelore si më poshtë. Pavarësisht se jo detyrimisht vlera e detyrimeve të deklaruar ka qenë burim për të shtuar vlerën e pasurisë, është me interes të shihet sa për qind të vlerës së aseteve e zënë detyrimet, dhe kjo e dhënë pasqyrohet në kolonën e fundit të tabelës nr.7.

Tabela nr.7: Raporti në përqindje mes detyrimeve totale dhe aseteve në fund të vitit 2015

Subjekti	Asetet me datë 31/12/2015	Detyrimet totale deri me datë 31/12/2015	Raporti detyrime/asete
Altina Xhoxhaj	35.535.340	5.947.600	17%
Bashkim Dedja	47.868.967	17.069.308	36%
Besnik Imeraj	27.050.737	7.600.000	28%

Fatmir Hoxha	23.383.913	23.062.970	99%
Fatos Lulo	92.037.826	-	0%
Gani Dizdari	37.153.671	12.525.240	34%
Sokol Berberi	32.127.435	11.797.952	37%
Vitore Tusha	13.428.520	8.534.148	64%
Vladimir Kristo	55.677.377	2.205.720	4%

Raporti Detyrime/Likuiditete Cash

Duke parë më nga afër në zërat përbërës të kategorisë së aseteve, do të veçojmë Likuiditetet Cash, që në total rezultoi në vlerën 54,290,936 lekë për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Në Tabelën nr. 8 më poshtë paraqitet raporti i likuiditeteve Cash që ka secili gjyqtar në krahasim me totalin e detyrimeve të deklaruara ndër vite.

Krahasimi i këtyre dy kategorive, nisët nga një pyetje logjike: *Cila është arsyeja që subjektet i drejtohen institucioneve bankare për të marrë kredi, kur disponojnë gjendje cash në shtëpi?*

Më poshtë tabela jep informacion për disa raste të veçanta lidhur me këtë raport:

- Subjekti merr kredi (apo lloje të tjera të detyrimeve) pasi nuk disponon gjendje Cash;
- Subjekti disponon gjendje të konsiderueshme Cash, por nuk ka asnjë detyrim ndaj institucioneve financiare apo palëve të treta;
- Subjekti ka likuiditete Cash në shumë më të madhe se sa detyrimet e marra;
- Subjekti ka detyrime më të larta se sa gjendja e likuiditeteve Cash.

Të gjitha këto marrëdhënie pasqyrohen në tabelën e mëposhtme duke krahasuar raportin Likuiditete Cash – Detyrime për secilin nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Tabela nr.8: Vlerat akumulative të likuiditeteve në Cash dhe detyrimeve të subjekteve në fund të vitit 2015

Subjekti	Likuiditete ne Cash dt.31/12/2015	Detyrimet totale deri me dt 31/12/2015
Altina Xhoxhaj	14.560.240	5.947.600
Bashkim Dedja	4.654.295	17.069.308
Besnik Imeraj	3.501.580	7.600.000
Fatmir Hoxha	1.597.804	23.062.970

Fatos Lulo	18.080.000	-
Gani Dizdari	9.487.617	12.525.240
Sokol Berberi	-	11.797.952
Vitore Tusha	1.308.800	8.534.148
Vladimir Kristo	1.100.600	2.205.720

2.c. Detyrimet e pashlyera

SA ËSHTË VLERA E DETYRIMEVE TË PASHLYERA NË FUND TË VITIT 2015?

Më sipër është identifikuar totali i detyrimeve të deklaruara nga gjyqtarët dhe familjarët e tyre ndër vite. Kjo vlerë është 88,742,938 lekë, e cila përmbledh të gjitha detyrimet e deklaruara në nënkategoritë e ndryshme, por, është e rëndësishme që të identifikohet edhe shuma e pagesës/kthimit të detyrimit, e paguar në formë kësti përgjatë viteve. Për këtë qëllim, siç shpjegohet dhe në kapitullin e Metodologjisë, të gjitha pagesat e detyrimeve janë regjistruar si nënkategori e veçantë tek kategoria e "Shpenzimeve" në databazën kryesore (referoju Aneksit I të këtij raporti 'Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive').

Kështu, gjendja e detyrimit të pa shlyer në fund të vitit 2015 përlogaritet duke zbritur nga shuma totale e detyrimeve të deklaruara gjatë gjithë periudhës së deklarimit totalin e pagesave për shlyerje detyrimesh gjatë gjithë periudhës, sipas formulës së mëposhtme:



Në këtë mënyrë, nëse shumës së detyrimeve të akumuluar ndër vite me vlerë 88,742,938 lekë, i zbrësim totalin e pagesave të kësteve (pagesë kësti kredie, kthim huaje, etj.) në shumën 47,899,299 lekë, atëherë gjendja e pashlyer e detyrimit në fund të vitit 2015 për të 9 gjyqtarët e

Gjykatës Kushtetuese përlllogaritet në vlerën 40,843,639 lekë (Tabela 9).

Tabela nr. 9: Vlera e detyrimeve të pashlyera në fund të vitit 2015 e shprehur në lekë.

Shuma totale e detyrimeve të deklaruara gjatë gjithë periudhës së deklaramit (a)	Totali i pagesave për shlyerje detyrimesh gjatë gjithë periudhës (b)	Gjendja e detyrimit të pashlyer në fund të vitit 2015 (a-b)
88,742,938 lekë	47,899,299 lekë	40,843,639 lekë

Pavarësisht se detyrimet e pashlyera në total zënë 46% të vlerës fillestare të detyrimit, nëse analizojmë detyrimin e pashlyer ndaj nënkategorive kryesore të deklaruara të detyrimeve, vërejmë se në fund të periudhës deklaruese të marrë në shqyrtim, vlera e pashlyer mes nënkategorive të ndryshme ndryshon (Tabela 10).

Tabela nr.10: Gjendja e detyrimit të pashlyer në fund të vitit 2015 sipas nënkategorive të detyrimeve

Detyrimet	Vlera e detyrimeve deri me 31.12.2015	Shlyerjet totale	Detyrim i pakthyer
Kredi Bankare	47,412,096	19,054,133	28,357,963
Detyrime shoq. ndertimit	32,885,937	24,731,100	8,154,837
Huamarrje	8,444,905	4,114,066	4,330,839

Pra, detyrimi i pakthyer lidhur me kreditë bankare rezulton të jetë në masën 60%, lidhur me detyrimet në formë huaje rezulton të jetë në masën 51%, ndërsa detyrimi i pakthyer ndaj shoqërive të ndërtimit rezulton të jetë në masën 25%.

3. PASURIA NETO

SI KA NDRYSHUAR PASURIA NETO NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2015?

Pasuria neto përcakton diferencën mes asetëve, pasurisë bruto të prezantuar në pikën 1 të këtij kapitulli, dhe vlerës së detyrimeve të pashlyera në fund të periudhës së deklaramit të përlllogaritur më lart, sipas Tabelës 11 më poshtë.

Kjo formulë na mundëson përlllogaritjen e vlerës akumulative të pasurisë neto që gjyqtarët zotërojnë në fund të vitit 2015 (Tabela 11), por dhe rritjen e pasurisë neto gjatë periudhës së deklaramit të marrë në analizë.

Tabela nr.11: Vlera e pasurisë neto të gjyqtarëve në fund të vitit 2015 e shprehur në lekë.

Subjekti	"(a) Asetet bruto"	"(b) Detyrimet e pashlyera"	"(a)-(b) Asetet neto"
Altina Xhoxhaj	35.535.340	305.723	35.229.616
Bashkim Dedja	47.868.967	14.416.874	33.452.093
Besnik Imeraj	27.050.737	4.865.536	22.185.201
Fatmir Hoxha	23.383.913	10.427.376	12.956.536
Fatos Lulo	92.037.826	-	92.037.826
Gani Dizdari	37.153.671	2.731.660	34.422.011
Sokol Berberi	32.127.435	5.084.567	27.042.868
Vitore Tusha	13.428.520	2.998.222	10.430.298
Vladimir Kristo	55.677.377	13.680	55.663.697
Total	364.263.786	40.843.639	323.420.147

Nga rezultati i kësaj tabele, shihet që: **Pasuria neto e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 323.420.147 lekë.**

Njëkohësisht nëse i rikthehemi tabelës nr.2 ku pasqyrohet ndryshimi i pasurisë nga fillimi i detyrës deri me datë 31.12.2015, përkatësisht në shumën 203,647,096 lekë, dhe kësaj shume i zbrisim totalin e detyrimeve të pashlyera në shumën 40.843.639 lekë, rezulton se:

Shtesa e pasurisë neto për periudhën e deklarimit për të gjithë gjyqtarë e Gjykatës Kushtetuese është 162,803,457 lekë.

Niveli i rritjes së pasurisë neto të gjyqtarëve të Apelit në periudhën deklaruese është i lartë dhe nuk mund të justifikohet vetëm me të ardhurat nga funksioni i tyre, sidomos kur kësaj vlere i janë zbritur të gjithë detyrimet ndaj bankave, shoqërive ndërtuese ose personave të tretë, të cilat janë po ashtu të larta. Ky rezultat detyron marrjen në analizë të strukturës së të ardhurave të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre, për të identifikuar më qartë burimin e rritjes së pasurisë.

4. TË ARDHURAT

Kategoria e të ardhurave të zyrtarëve që janë subjekt i deklarimit të pasurisë, përbëhet nga këto nënkategori kryesore:

- Paga nga funksioni;
- Paga e familjarëve;
- Shpërblime neto;
- Të ardhura nga biznesi;
- Të ardhura nga qeradhënia;
- Të ardhura nga mësimdhënia (vetëm për gjyqtarët);
- Dhuratat në cash nga persona jashtë përbërjes familjare;
- Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme;
- Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme;
- Të ardhura të tjera (për të ardhurat që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme).

4.a. Totali i të ardhurave

SA ËSHTË TOTALI I TË ARDHURAVE NGA FILLIMI I DETYRËS DERI NË VITIN 2015?

Nëse përllogarisim totalin e të ardhurave të deklaruara nga vetë gjyqtarët dhe familjarët e tyre për periudhën 2003-2015, pra në të gjitha deklaratat e interesave private, vlera totale e deklaruar është në shumën 329,904,731 lekë.

Megjithatë, ndryshe nga përllogaritja e vlerës së aseteve të deklaruara e cila është akumulative nga viti i parë (viti 0) i deklarimit deri në deklaratën e fundit, në përllogaritjen e të ardhurave duhet të kemi parasysh se të ardhurat që deklarohen në formularin e deklarimit Para Fillimit të Detyrës, sipas nenit 5/1 të Ligjit nr.9049, përfshijnë: "angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit."

Për këtë arsye në trajtimin e të ardhurave si burim financiar për krijimin e pasurisë së deklaruar, do të llogarisim vetëm të ardhurat e krijuara nga subjektet deklarues dhe familjarët e tyre pas datës së emërimit (pas datës së fillimit të deklarimit të pasurisë). Pra, do të merren për bazë të ardhurat nga viti 2004 deri në vitin 2015, që i korrespondon formularëve të deklarimit periodik vjetor, ashtu siç ato paraqiten në Tabelën nr.12.

Tabela nr.12: Të ardhurat totale dhe mesatare vjetore gjatë viteve të deklarimit

Subjekti	Të ardhurat në Lekë	Vitet në Funkcion	Të ardhurat vjetore mesatare
Altina Xhoxhaj	37.489.149	12	3.124.096
Bashkim Dedja	40.705.523	12	3.392.127
Besnik Imeraj	35.167.115	12	2.930.593
Fatmir Hoxha	24.188.582	12	2.015.715
Fatos Lulo	51.944.805	11	4.722.255
Gani Dizdari	26.245.738	9	2.916.193
Sokol Berberi	37.540.283	9	4.171.143
Vitore Tusha	36.472.435	8	4.559.054
Vladimir Kristo	40.151.101	10	4.015.110
Total	329.904.731	N/A	N/A

4.b. Burimi i të ardhurave

SI JANË TË NDARA KËTO TË ARDHURA SIPAS NËNKATEGORIVE?

Duke qenë senë totalin e saj, rritja e pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nuk justifikohet nga të ardhurat e përftuara nga rroga/shpërblimet, BIRN analizoi në mënyrë të detajuar burimet e të ardhurave të deklaruara nga këta gjyqtarë, në mënyrë që të identifikonte më qartë strukturën e kësaj pasurie.

Nënkategoritë që përbëjnë totalin e vlerës së të ardhurave të deklaruara nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë përmbledhëse janë klasifikuar në: Dhurata në Cash; Mësimdhënia; Paga e familjarëve; Paga nga funksioni; Shpërblime neto; Të ardhura nga biznesi; Të ardhura nga Qiradhënia; Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme; Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme; dhe Të ardhura të tjera. Në mënyrë që të diferencohet burimi i të ardhurave, baza e të dhënave të ngritur për qëllim të këtij studimi ka identifikuar secilën nga këto nënkategori, duke i dhënë dhe kode të ndryshme (referoju Aneksit I të këtij raporti).

Raporti ndërmjet këtyre nënkategorive në vlerë në Lek dhe në përqindje, për të gjithë gjyqtarët deklarues objekt të këtij studimi, është prezantuar në Tabelën 13 më poshtë.

Tabela nr.13: Vlera totale në lekë për secilën nënkategori të ardhurash dhe raporti mes tyre.

Të ardhurat	Shuma në Lek	Shuma në %
Paga nga funksioni	171,746,185	52.1%
Paga e familjarëve	69,047,439	20.9%
Te ardhura te tjera	26,258,992	8.0%
Fitimi nga shitblerja	23,935,941	7.3%
Dhurata ne Cash	21,612,365	6.6%
Mesimdhënia	7,868,293	2.4%
Të ardhura nga Qira	6,378,443	1.9%
Të ardhura nga biznesi	2,400,000	0.7%
Shperblime neto	657,072	0.2%
Total	329,904,731	100%

Ashtu siç pasqyrohet dhe nga të dhënat e prezantuara në Tabelën 13, më shumë se 2/3 e të ardhurave të gjyqtarëve deklarohet se burojnë nga paga e tyre ose e familjarëve, të cilat zënë respektivisht 52.1% dhe 20.9% të shumës totale të të ardhurave të deklaruara.

Pesë nënkategoritë kryesore të të ardhurave të cilat janë përgjegjëse për rreth 1/3 e shumës së të ardhurave të gjyqtarëve janë: të ardhura të tjera (8%); të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme (7.3%); dhurata në Cash (6.6%); të ardhura nga mësimdhënia (2.4%) dhe të ardhura nga qiradhënia (1.9%). Zërat e tjerë të kategorisë 'Të Ardhura' zënë një përqindje të vogël në krahasim me vlerën totale.

Pavarësisht se pjesa më e mirë e të ardhurave të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese burojnë nga pagat, është e rëndësishme të theksohet se subjektet në këtë studim deklarojnë se kanë përfituar rreth 22 milion lekë (6.6% e totalit të të ardhurave) nga dhurata në Cash. Vlera të larta të të ardhurave nga dhurata në Cash konsiderohen në praktikën ndërkombëtare të kontrollit të pasurisë si 'flamuj të kuq' dhe indicje për organin që administron kontrollin e pasurisë (ILDKPKI), për një kontroll më të thelluar të subjektit deklarues dhe të familjarëve të tij.



Rreth 22 milion lekë nga shuma e të ardhurave të gjyqtarëve burojnë nga dhuratat në Cash.

5. SHPENZIMET

Pasi kemi marrë në analizë të ardhurat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që përfshihen në kategorinë e transaksioneve të parasë në hyrje, është e rëndësishme të shihet struktura e shpenzimeve të tyre, që klasifikohet në kategorinë e rrjedhjes së parasë në dalje.

Në kategorinë e shpenzimeve, përfshihen këto nënkategori kryesore:

- Pagesë kësti kredie;
- Pagesë kësti huaje;
- Pagesë e kryer ndaj shoqërisë së ndërtimit ku ka pasur detyrime;
- Shpenzime shkollimi;
- Shpenzime të tjera (të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme).

Duke vlerësuar me kujdes mënyrën e plotësimit të rubrikës së detyrimeve dhe pagesës së kësteve nga ana e subjekteve deklarues, u konstatua që këstet e paguara përfshijnë në masën më të madhe kthimin e principalit dhe pjesërisht pagesë interesi, por që ky i fundit është i pamundur të identifikohet. Pra, vetëdeklarimet për pagesë këstesh do t'i trajtojmë si pakësim detyrimi dhe janë përfshirë në seksionin "2.c. Detyrimet e pashlyera" të prezantuar më lart.

Kategoria e shpenzimeve, ka një specifikë të veçantë në formularin e deklarimit. Detyrimi ligjor për deklarimin e "shpenzimeve të deklarueshme"³ ka hyrë në fuqi nga viti 2014 pas amendimit të fundit ligjor që iu bë ligjit nr.9049, referuar nenit 1 pika 7 të këtij ligji. Por edhe pas këtij ndryshimi ligjor, në formatin e deklaratës "Deklaratë e Interesave Private Periodike/Vjetore" shpenzimet e deklarueshme janë klasifikuar si e dhënë konfidenciale dhe për këtë arsye nuk ofrohen për publikim.

Kështu pra, rezulton që të dhënat për shpenzime të tjera klasifikohen si më poshtë:

Tabela nr.14: Vlera e shpenzimeve të deklaruara në lekë

Shpenzimet	Shuma në Lekë
Shpenzime shkollimi	3.489.800
Shpenzime të tjera	259.642
Total	3.749.442

³"Shpenzim i deklarueshëm" është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues.

Nga ky informacion, theksojmë se vetëm një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka deklaruar shpenzime shkollimi për fëmijët në shumën 3,489,800 lekë për periudhën e marrë në shqyrtim. Megjithatë mbetet e zbuluar dhe jo e qartë analiza për shpenzimet e subjekteve deklarues, për sa kohë që rubrika e Shpenzimeve të Deklarueshme është konfidenciale dhe nuk ofrohet për publikim.

Gjithashtu, analizimi i 106 deklaratave të këtij studimi nxjerr në pah mungesën e deklarimeve të gjyqtarëve për shpenzime jetike, shpenzime udhëtimi, etj., duke theksuar nevojën e përfshirjes së të gjithë shpenzimeve në deklaratat e interesave private, si një mundësi më e mirë drejt nxitjes së transparencës. Nga 9 gjyqtarët e marrë në analizë, asnjë prej tyre nuk ka deklaruar shpenzime të konsumit jetik.



Asnjë nga 106 deklaratat e analizuara nuk përfshinin në kategorinë e shpenzimeve, kosto të lidhura me konsumin jetik.

6. TË ARDHURAT NETO

Të ardhurat neto përftohen si rezultat i diferencës mes të ardhurave totale me shpenzimet e deklaruara, duke iu referuar deklaratave periodike/vjetore të 9 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas skemës që vijon:



Pra, të ardhurat neto për 9 gjyqtarët dhe familjet e tyre për periudhën deklaruese janë në shumën 326,155,289 lekë.

Kjo shifër jep të ardhurat neto, por duhet theksuar se në asnjë rast në zërin e shpenzimeve nuk janë përfshirë shpenzimet e konsumit jetik. Nëqoftëse shpenzimet e konsumit jetik do të përfshihen në përlogaritje, të ardhurat neto do të rezultonin ndjeshëm më të ulëta.

7. KONTROLI ARITMETIK DHE LOGJIK

Nga analiza e strukturës së aseteve dhe detyrimeve nga njëra anë dhe të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana tjetër, të 9 gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e bazuar në vetëdeklarimet e tyre të bëra pranë ILDKPKI për periudhën nga fillimi i detyrës deri me datë 31/12/2015, vërehen një numër trendesh në transaksione të identifikuara si të dyshimta ose 'flamuj të kuq' bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Në këtë kontekst, BIRN ndërmori kontrollin aritmetik-logjik të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, deri me datë 31.12.2015. Kjo analizë u realizua bazuar në të dhënat e deklaratave të subjekteve, si dhe ato të familjarëve të tyre. Qëllimi i këtij kontrolli është të vlerësojë efektshmërinë e kontrolleve aritmetike-logjike të cilat kryhen nga ILDKPKI gjatë çdo viti kalendarik të dorëzimit të deklaratave të interesave private të zyrtarëve.

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 9049 i ndryshuar, *"Kontrolli aritmetik dhe logjik kryhet për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurive nga burime të deklaruar"*. Ky kontroll dokumentohet në Fletën e Kontrollit, në të cilin janë pasqyruar të dhënat e vetëdeklaruar nga zyrtari dhe familjarët e tij, të organizuara në dy pasqyra financiare: asetet neto dhe të ardhurat neto. Pas plotësimit dhe përpunimit të këtyre të dhënave, gjenerohet një informacion lidhur me faktin nëse: *të ardhurat neto të periudhës justifikojnë apo jo ndryshimin e asetëve neto për periudhën deklaruese*.

Pavarësisht detyrimit ligjor që ka ILDKPKI për të ushtruar kontrollin aritmetik dhe logjik për çdo deklaratë që dorëzohet, BIRN ka kryer kontrollin Aritmetik dhe Logjik vetëm për deklaratat e interesave private Periodike/Vjetore. Pra është analizuar si ka ndryshuar pasuria e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga momenti që ata janë emëruar në një funksion publik duke u bërë subjekte të ligjit të deklaramit e deri me datë 31.12.2015.

Formula për ndërtimin e një flete kontrolli Aritmetik dhe Logjik paraqitet si më poshtë vijon:

***Rritja e Asetëve Neto = Rritja e Asetëve Bruto – Detyrime
Të Ardhura Neto = Të ardhurat totale – Shpenzime***

Rezultati:

- a) Nëse diferenca mes “Të Ardhurave Neto” dhe “Rritjes/Ndryshimit të Aseteve Neto” del me vlerë negative, atëherë ajo konsiderohet indicie që pasuria e krijuar gjatë vitit nuk justifikohet përmes burimeve financiare të deklaruara.
- b) Por nëse diferenca mes “Të Ardhurave Neto” dhe “Rritjes/Ndryshimit të Aseteve Neto” është pozitive, atëherë shuma mund të trajtohet si shpenzim për periudhën, për sa kohë që vetë subjekti nuk e ka deklaruar destinacionin e kësaj teprice likuiditeti. Pra në mungesë të shpenzimeve të deklarueshme, konkludojmë që çdo tepricë pozitive nga kontrolli KAL, mes të ardhurave neto dhe asetëve neto, është shpenzim.

Duke qenë se kontrolli aritmetik dhe logjik duhet të kryhet për secilën periudhë deklaruese, pra për secilën deklaratë individuale, duke eliminuar vitin fillestar të deklarimit (Deklarata e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës), kontrolli aritmetik dhe logjik është kryer për 97 deklarata Periodike/Vjetore të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese.

SA ËSHTË PASURIA E PAJUSTIFIKUAR SIPAS REZULTATIT TË KONTROLLIT ARITMETIK DHE LOGJIK?

Në përfundim të kontrollit aritmetik dhe logjik, ka rezultuar se nga 97 deklarata që iu nënshtruan kontrollit, 14 prej tyre janë me probleme, duke qenë se shtesa e asetëve neto nuk justifikohet me të ardhurat neto (Tabela 15).

Tabela nr.15: Numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë

Subjekti	Deklaratat per KAL	KAL me probleme	KAL pa probleme
Altina Xhoxhaj	12	2	10
Bashkim Dedja	12	1	11
Besnik Imeraj	12	1	11
Fatmir Hoxha	12	1	11
Fatos Lulo	12	0	12
Gani Dizdari	10	4	6
Sokol Berberi	9	2	7
Vitore Tusha	8	0	8
Vladimir Kristo	10	3	7
Total	97	14	83

Pra, vetëm dy nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese kanë rezultuar pa probleme në të gjitha vitet e deklarimit.

Pra, nga sa u tha mësipër, rezulton se:

Nga 97 deklaratat, 14 prej tyre janë me probleme mosmbulimi të pasurisë së shtuar me të ardhurat që deklarojnë.

Në këtë përlogaritje i jemi referuar me përpikmëri çdo të dhëne të deklaruar nga subjekti dhe familjarët e tyre në formularët e deklarimit Periodik/Vjetor.



Rreth 14% e deklaratave Periodike/Vjetore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dështojnë gjatë kontrollit aritmetik dhe logjik.

Në total, shuma e pajustificuar e përmbledhur tek 14 deklaratat që dështojnë gjatë kontrollit aritmetik dhe logjik është 35,285,915 lekë, e cila përbën rreth 11% të vlerës së asetëve neto të deklaruara.



Rreth 11% e pasurisë neto të deklaruar rezulton e pajustificuar me burime financiare.

SI INTERPRETOHET REZULTATI I DEKLARATAVE TË TJERA QË NGA KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK KANË REZULTUAR ME VLERA POZITIVE?

Sërish, duke iu kthyer rezultatit të tabelës nr.15, ka rezultuar që numri i deklaratave pa probleme nga kontrolli aritmetik dhe logjik, është 83. Duke iu referuar ligjit dhe udhëzimeve për plotësimin e formularëve të deklarimit, si dhe faktit që nuk disponohen të dhëna për shpenzimet e deklarueshme, rezulton që diferenca mes:

Të ardhurave neto dhe asetëve neto, na jep vlerën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit nga subjekti dhe familjarët e tij.

Në arritjen e këtij konkluzioni është arritur duke patur parasysh se subjekti ka detyrim për të deklaruar gjendjen Cash për secilin vit, dhe nëse subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash nga kursimet e vitit paraardhës, kjo do të thotë se subjekti ka shpenzuar cdo të ardhur të realizuar.

Pra, përveç rasteve të 14 deklaratave që rezultuan me diferencë negative mes të ardhurave neto dhe aseteve neto, rastet e tjera me diferencë pozitive (83 deklarata), na japin informacion për vitet që ka pasur tepricë të ardhurash dhe kjo diferencë në kushtet e respektimit të rregullave të plotësimit të formularit të deklarimit, interpretohet si shpenzim vjetor.

Tabela nr.16: Vlera mesatare vjetore e shpenzimeve të deklaruara.

Subjekti	KAL pa probleme	Shpenzimet e përlogaritura në total	Shpenzimi mesatar vjetor I përlogaritur
Altina Xhoxhaj	10	18.172.273	1.817.227
Bashkim Dedja	11	14.956.984	1.359.726
Besnik Imeraj	11	27.277.980	2.479.816
Fatmir Hoxha	11	14.284.873	1.298.625
Fatos Lulo	12	34.474.979	2.872.915
Gani Dizdari	6	5.797.513	966.252
Sokol Berberi	7	27.328.018	3.904.003
Vitore Tusha	8	30.352.250	3.794.031
Vladimir Kristo	7	8.019.876	1.145.697
Total	83	180.664.747	19.638.292

Vlera mesatare e shpenzimeve vjetore varion nga 966,252 lekë (vlera minimale) në 3,904,003 lekë (vlera maksimale).

SA ËSHTË PASURIA E PAJUSTIFIKUAR ME BURIME FINANCIARE NËSE ZBRESIM SHPENZIMET E KONSUMIT JETIK SIPAS INSTAT?

Shpenzimet konsiderohen një e dhënë personale dhe klasifikohen në kategorinë e të dhënave konfidenciale në formularin e vetëdeklarimit. Në qoftë e rikthehemi dhe një herë në të dhënat bazë që janë vetëdeklaruar, kujtojmë se asnjëri nga 9 gjyqtarët, objekt i këtij studimi, nuk kanë deklaruar shpenzime të konsumit familjar (ose janë deklaruar në rubrikën e Shpenzimeve të Deklarueshme, por që mbetet konfidenciale dhe jo i aksesueshëm nga publiku). Në këto kushte do t'i referohemi të dhënave që publikon Instituti i Statistikave në Shqipëri lidhur me konsumin mesatar vjetor për familje.

Nga botimet e publikuara në faqen zyrtare në web, për buxhetin e familjes, ka informacion vetëm për vitin 2006, 2014 dhe 2015; përkatësisht konsumi mesatar mujor është në shumat 69,383 lekë,

69,442 lekë dhe 70,766 lekë. Do të merret si e dhënë referuese konsumi mesatar mujor për familje i vitit 2006 (69,383 lekë), dhe do t'i rikthehemi sërish Kontrollit Aritmetik dhe Logjik për secilën deklaratë periodike/vjetore. Për këtë arsye, ILDKPKI përdor minimumin jetik vjetor për një familje, siç përllogaritet nga Instituti i Statistikave, INSTAT, në praktikën e saj të kontrollit aritmetik dhe logjik.

Pra, për secilën deklaratë periodike/vjetore, shtuam koston vjetore⁴ mesatare të jetesës për familje sipas INSTAT-it. Si rrjedhojë, vlera e të ardhurave neto zvogëlohet, duke ndikuar në rritjen e vlerës së pasurisë së pajustificuar. Nëse shpenzimeve të gjyqtarëve u shtohet edhe kosto e minimumit jetik vjetor sipas INSTAT, atëherë numri total i deklaratave vjetore me probleme në periudhën deklaruese, arrin në 26 deklaratat nga 97 gjithsej, ose 27% të totalit të deklaratave (Tabela 17).

Tabela nr.17: Numri i deklaratave që nuk justifikojnë pasurinë nëse shpenzimeve i shtohen kostot e konsumit jetik të INSTAT

Subjekti	Deklaratat per KAL	KAL me probleme	KAL pa probleme
Altina Xhoxhaj	12	4	8
Bashkim Dedja	12	2	10
Besnik Imeraj	12	2	10
Fatmir Hoxha	12	4	8
Fatos Lulo	12	0	12
Gani Dizdari	10	7	3
Sokol Berberi	9	2	7
Vitore Tusha	8	0	8
Vladimir Kristo	10	5	5
Total	97	26	71



Rreth 27% e deklaratave Periodike/Vjetore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dështojnë gjatë kontrollit aritmetik dhe logjik nëse shpenzimeve i shtohen kostot e konsumit jetik të INSTAT.

⁴Kostoja mesatare vjetore e jetesës, u llogarit duke shumëzuar numrin e muajve në funksion me koston mesatare mujore të jetesës për familjes sipas INSTAT

IV. Diskutime dhe rekomandime

Analiza strukturore e të dhënave të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese identifikon një numër trendesh ku përfshihen transaksione të dyshimta ose 'flamuj të kuq' në kampinonin prej 9 gjyqtarësh, ku përfshihen:

- Mbajtja e likuiditeteve të larta cash, jashtë sistemit bankar;
- Shuma të larta të huamarrjes nga persona të lidhur, pa afat dhe pa interes;
- Detyrime të larta të pashlyera ndaj kompanive të ndërtimit;
- Të ardhura të larta nga dhurata në Cash.

Përveç 'flamujve të kuq' të sipërpërmendur, të cilat u përfatuan nga analiza strukturore e të dhënave, nga kontrolli aritmetik dhe logjik i deklaratave të pasurisë së këtyre subjekteve të ligjit për deklarimin e pasurisë, rezulton se një numër shumë i lartë i gjyqtarësh nuk e justifikojnë dot pasurinë, të paktën gjatë një pike të caktuar në karrierën e tyre.

- 7 nga 9 gjyqtarë gjithsej rezultojnë se kanë pasur të paktën në një vit të karrierës së tyre diferencë të pajustificuara midis pasurisë së krijuar dhe burimeve financiare të deklaruara.

Të dhënat e sipërcituara mbi 'flamujt e kuq' të identifikuar, tregojnë që origjina e një pjese të pasurisë së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ngre dyshime se mund të ketë prejardhje nga burime të paligjshme, të cilat idealisht duhet ta kishin shtyrë ILDKPKI-në për të ndërmarrë hetime të thelluara administrative ndaj këtyre subjekteve.

Gjithashtu, të dhënat e përfuara nga kontrolli aritmetik dhe logjik i deklaratave, tregojnë që një numër i madh gjyqtarësh, nuk arrin ta justifikojë pasurinë e tij/saj të paktën në një vit gjatë karrierës brenda sistemit gjyqësor, çfarë ngre pikëpyetje mbi efektshmërinë e kontrollit të ILDKPKI mbi këta subjekte deklarues, në të kaluarën.

Megjithatë, duke qenë se nën dritën e procesit të vetingut, pasuria e gjyqtarëve do të merret përsëri në sitë nga ILDKPKI, si një nga institucionet që do të asistojë Komisionin e Pavarur të Vettingut në vlerësimin e integritet të gjyqtarëve për sa i përket pasurisë, puna e këtij institucioni në këtë drejtim mund të përmirësohet duke ndërmarrë një sërë masash të brendshme apo nga ndërveprimi i me aktorë të jashtëm.

Në këtë drejtim autorët e këtij raporti do të listonin rekomandimet e mëposhtme:

- Përdorimin e një formulari elektronik për deklarimin e pasurisë, i cili jep mundësi për analizimin më të thjeshtë të dhënash dhe shmang gabimet nga plotësimet me shkrim dore të formularëve të vetdeklarimit.
- Krijimi i një baze të dhënash elektronike për deklaratat e pasurisë, e cila i jep mundësi ILDKPKI-së, studiuësve dhe gazetarëve që të analizojnë trendet e pasurimit të zyrtarëve publikë.
- Ndërmarrja e studimeve/monitorimeve të ngjashme nga organizatat e shoqërisë civile mbi trendet/strukturën e pasurisë së gjyqtarëve të shkallës së parë, apo të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
- Kontroll i pavarur aritmetik-logjik i deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve/prokurorëve që përfshihen në procesin e vetingut nga organizatat e shoqërisë civile dhe media.
- Rritja e kapaciteteve dhe transparencës së ILDKPKI, për të publikuar raporte periodik mbi trendet e pasurisë së zyrtarëve publikë.
- Shtrirja e hetimit administrativ nga ana e ILDKPKI në tregun imobiliar, me qëllim identifikimin e pasurive të paluajtshme që rezultojnë të pa rregjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Publikimi i shpenzimeve të deklarueshme të subjekteve deklarues;
- Zhvillimi i teknikave të hetimit, kryesisht në rivlerësimin nga ekspertë të pavarur të pasurive të paluajtshme, për objektet që vetëdeklarohen me çmime nën vlerën e tregut. (Gjithashtu nuk deklarohen shpenzimet për mobilimin e shtëpive);
- Aplikimi i deklarimit me kërkesë për personat e lidhur (jashtë përbërjes familjare), kur ka dyshime për aftësinë financiare të një huadhënësi apo dhuruesi) etj dhe ushtrimi i hetimit të plotë administrativ për personin e lidhur;
- Sanksione administrative për personat e lidhur në rast shkeljesh administrative.

Aneksi I

Kodifikimi i kategorive dhe nënkategorive

Kodi_nënkategori	Nënkategoria	Kategoria
11	Pasuri të Paluajtshme	Asetet
12	Pasuri të Luajtshme	Asetet
13	Likuiditete në Cash	Asetet
14	Likuiditete në Bankë	Asetet
15	Pjesë në kapital/Aksione	Asetet
16	Person Fizik	Asetet
17	Sende me vlerë të veçantë	Asetet
18	Huadhënie	Asetet
19	Asete të tjera	Asetet
21	Kredi Bankare	Detyrimet
22	Huamarrje	Detyrimet
23	Detyrime ndaj shoqërive të ndërtimit	Detyrimet
24	Detyrime të tjera	Detyrimet
31	Paga nga funksioni	Të Ardhurat
32	Paga e familjarëve	Të Ardhurat
33	Shpërblime neto	Të Ardhurat
34	Të ardhura nga biznesi	Të Ardhurat
35	Të ardhura nga Qira	Të Ardhurat
36	Mësimdhënia	Të Ardhurat
37	Dhurata në Cash	Të Ardhurat
38	Të ardhura të tjera	Të Ardhurat
391	Të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme	Të Ardhurat
392	Te ardhura nga shitja e pasurive te luajtshme	Të Ardhurat
393	Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme	Të Ardhurat
411	Pagesë kësti kredie	Shpenzime
412	Pagesë kësti huaje	Shpenzime
413	Pagesë ndaj shoqërisë së ndërtimit	Shpenzime
42	Shpenzime shkollimi	Shpenzime
43	Shpenzime të tjera	Shpenzime

Aneksi II

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja në Lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë

Periudha	Konvertimi në Lekë sipas Bankës së Shqipërisë				
	EUR	USD	GBP	CHF	CAD
31.12.2003	133.65	108.69	190.25	85.97	82.76
31.12.2004	126.74	92.64	178.69	81.87	76.92
31.12.2005	122.54	103.58	178.65	78.86	89.11
31.12.2006	123.85	94.14	184.65	77.17	81.13
31.12.2007	121.78	82.89	166.02	73.65	84.45
31.12.2008	123.8	87.91	127.66	82.97	72.22
31.12.2009	137.96	95.81	154.64	93.04	91.34
31.12.2010	138.77	104	161.46	110.98	104.29
31.12.2011	138.93	107.54	165.92	114.46	105.36
31.12.2012	139.59	105.85	171.18	115.65	106.37
31.12.2013	140.2	101.86	168.39	114.41	95.7
31.12.2014	140.14	115.23	179.48	116.52	99.55
31.12.2015	137.28	125.79	186.59	126.74	90.53

**ANALIZË E SISTEMIT TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURISË SË GJYQTARËVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

**© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2017**